

VENDIM
Nr. 717, datë 11.11.2022

PËR SHPALLJEN E “ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK” DHE ZHVILLUESIT TË ZONËS ME VENDNDODHJE NË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 9, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14/1, të vendimit nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave e të kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, të territorit me sipërfaqe 342 185 m² (treqind e dyzet e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) m², pjesë të zonave kadastrale nr. 3866, nr. 2105 dhe nr. 1867, në Tiranë, të përbërë nga parcelat me numrat e pasurive dhe sipërfaqet përkatëse, sipas listës dhe genplanit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes e të daljes së “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, përcaktohen në genplanin, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaritë, që do të zhvillohen në “Zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, janë të llojit:

- a) industria e automobilitave;
- b) industria e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT);
- c) industria e pajisjeve elektronike;
- ç) industria farmaceutike;
- d) industria agropërpunuese;
- dh) industritë prodhuese;
- e) industri të tjera në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4. Periudha e funksionimit të “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, është 35 vjet, me të drejtë përsëritjeje deri në 99 vjet.

5. Zhvillues i “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, shpallet Bashkia Tiranë.

6. Masat mbështetëse të përfituara nga Bashkia Tiranë, si subjekt përfitues i statusit “Investim/investitor, procedurë e veçantë”, bazohen në vendimin nr. 1/8, datë 15.7.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike.


7. Për pjesët e sipërfaqes së “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, që janë pronë private, të bëhet shpronësimi dhe/ose kompensimi, sipas ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ZONA TEKNOLOGJIKE E ZHVILLIMIT EKONOMIK (TEDA) TIRANË, GENPLAN I ZONËS



LISTA E PASURIVE ZONA E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK “TEDA”, TIRANË

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²	Statusi
1	3866	116/10	Arë	4200	Shtet
2	3866	116/11	Arë	4200	Shtet
3	3866	116/12	Arë	5281	Privat
4	3866	116/13	Arë	947	Shtet
5	3866	116/17	Arë	5750	Privat
6	3866	116/19	Arë	5000	Privat
7	3866	116/2	Arë	8000	Privat
8	3866	116/20	Arë	4000	Privat

9	3866	116/21	Arë	4200	Shtet
10	3866	116/23	Arë	2100	Privat
11	3866	116/24	Arë	2100	Privat
12	3866	116/25	Arë	2100	Privat
13	3866	116/26	Arë	2200	Privat
14	3866	116/29	Arë	5337	Privat
15	3866	116/3	Arë	5550	Privat
16	3866	116/30	Arë	7585	Shtet
17	3866	116/31	Arë	2500	Shtet
18	3866	116/32	Arë	4585	Shtet
19	3866	116/33	Rrugë	829	Shtet
20	3866	116/34	Arë	850	Shtet
21	3866	116/35	Arë	3750	Shtet
22	3866	116/37	Arë	3800	Privat
23	3866	116/38	Arë	512	Shtet
24	3866	116/39	Arë	1624	Privat
25	3866	116/4	Arë	6655	Shtet
26	3866	116/40	Arë	163	Shtet
27	3866	116/5	Arë	1980	Shtet
28	3866	116/6	Arë	6000	Privat
29	3866	116/8	Arë	4200	Shtet
30	3866	116/9	Arë	8000	Privat
31	3866	181/2	Arë	11000	Privat
32	3866	181/27	Arë	3700	Privat
33	3866	181/28	Arë	6500	Privat
34	3866	181/29	Arë	4500	Privat
35	3866	181/32	Arë	3700	Privat
36	3866	181/34	Arë	800	Privat
37	3866	181/35	Arë	2300	Privat
38	3866	181/51	Arë	4000	Privat
39	3866	181/52	Arë	4000	Privat
40	3866	181/53	Arë	2000	Privat
41	3866	181/54	Arë	3300	Privat
42	3866	181/56	Arë	2200	Shtet
43	3866	181/57	Arë	6500	Privat
44	3866	181/58	Arë	5000	Privat
45	3866	181/59	Arë	3000	Privat
46	3866	181/60	Arë	1700	Privat
47	3866	181/61	Arë	5950	Shtet
48	3866	181/62	Arë	3000	Privat
49	3866	181/68	Arë	1200	Privat
50	3866	181/69	Arë	3800	Privat
51	3866	181/72	Arë	8300	Shtet
52	3866	181/3	Arë	5300	Privat
53	3866	368/14	Kanal	2179	Shtet
54	3866	504	Rrugë	1798	Shtet
55	3866	606	Kanal	1663	Shtet
56	3866	607	Kanal	2553	Shtet
57	3866	608	Rrugë	2541	Shtet
58	3866	609	Kanal	2062	Shtet
59	1867	103	Kanal	953	Shtet
60	1867	104	Rrugë	2300	Shtet
61	1867	105	Kanal	1682	Shtet
62	1867	23/1	Arë	11000	Privat
63	1867	23/10	Arë	2550	Privat
64	1867	23/11	Arë	1507	Privat
65	1867	23/12	Arë	6000	Privat
66	1867	23/17	Arë	5800	Privat

67	1867	23/18	Arë	3900	Privat
68	1867	23/19	Arë	5600	Privat
69	1867	23/20	Arë	1600	Privat
70	1867	23/21	Arë	3900	Privat
71	1867	23/22	Arë	3600	Privat
72	1867	23/23	Arë	3100	Privat
73	1867	23/24	Arë	2300	Privat
74	1867	23/27	Arë	1000	Privat
75	1867	23/28	Arë	1500	Privat
76	1867	23/29	Arë	9700	Privat
77	1867	23/3	Arë	5100	Privat
78	1867	23/31	Arë	1500	Privat
79	1867	23/32	Arë	500	Privat
80	1867	23/5	Arë	6000	Privat
81	1867	23/6	Arë	3000	Privat
82	1867	23/7	Arë	5750	Privat
83	1867	23/8	Arë	4050	Privat
84	1867	23/9	Arë	2550	Privat
85	2105	562/1	Arë	10000	Privat
86	2105	562/10	Arë	1037	Privat
87	2105	562/11	Arë	1037	Shtet
88	2105	562/3	Arë	486	Shtet
89	2105	562/4	Arë	6760	Privat
90	2105	562/5	Arë	3097	Shtet
91	2105	562/6	Arë	2078	Shtet
92	2105	562/7	Kanal	630	Shtet
93	2105	562/8	Arë	1037	Privat
94	2105	562/9	Arë	1037	Privat
TOTAL				342185	